

Prof. Dr. Elida BYLYKU

E punësuar me kohë të plotë si personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Radiometrise dhe Radiokimise të Institutit të Fizikes Berthamore të Zbatuar, Universiteti i Tiranës.

Ka një përvojë pune 36 vjeçare si pedagoge dhe studiuese.

Pas diplomimit në Kimi, në vitin 1987, studimet pasuniversitare dhe ato doktorale lidhen me fushat e Radiokimise, Radiometrise, procedurave matese të radioaktivitetit në mostra mjedisore dhe ushqimore për qëllime monitorimi dhe në rastet e emergjencave radiologjike.

Ka mbrojtur titullin akademik Profesor në vitin 2015.

Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë fushen e radiokimise, radiometrise dhe matjes së radioaktivitetit në mostra të ndryshme si për qëllime monitoruese ashtu edhe në raste emergjencash radiologjike.

Ka marrë pjesë në disa projekte kombëtare/ndërkombëtare. Gjatë kryerjes së aktivitetit të saj shkencor ka qenë dhe është pjesë, si udhëheqëse ose pjesëmarrëse, në disa projekte shkencore, kombëtare, ndërkombëtare dhe rajonale, kryesisht të financuara nga Agjensia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, Vienë, Austri, në fushat e aplikimit të teknologjisë bërthamore në Monitorimin e Ambientit, Radiombrojtje, Emergjencat radiologjike, etj.

Ka shërbyer në pozicione drejtuese. Ka kryer detyrën e Drejtorit të Institutit të Fizikes Berthamore të Zbatuar duke u zgjedhur për dy mandate në periudhën 2013-2020.

Ka botuar duke paraqitur aktivitetin e saj shkencor me punime në mbi 30 Konferenca Kombëtare e Ndërkombëtare dhe mbi 22 artikuj shkencor në Revista Shkencore me faktor impakti.

Aktualisht është Zvdrejtore e IFBZ dhe anetare e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Universitetit të Tiranës.

Është anetare e Komisionit të Fizikë-Kimi pranë Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike, Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Prof. Dr. Bylyku është Oficere Ndërlidhëse për Shqipërinë me Agjensinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike me seli në Vienë, Austri, duke realizuar dhe koordinuar projektet e bashkëpunimit tekniko-shkencor ndërmjet institucioneve shkencore vëndase dhe të huaja që nga viti 2014 e në vazhdim.

Është anetare e Komisionit Institucional të Ekspertëve, për vlerësimin e projekteve të Programit “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion” në Universitetin e Tiranës”